“Atij që thotë: "Subhanallahil adhim ue bihamdih (I Lartësuar është Allahu i Madhëruar dhe Atij i takon falënderimi!), i mbillet një palmë hurme në Xhenet.”

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ka thënë: “Atij që thotë: "Subhanallahil adhim ue bihamdih (I Lartësuar është Allahu i Madhëruar dhe Atij i takon falënderimi!), i mbillet një palmë hurme në Xhenet.”
[Sahih] [Transmeton Tirmidhiu]

Profeti në këtë hadith ka njoftuar se kushdo që thotë: “Subhanallāh”, duke e madhëruar Allahun e Lartësuar në Qenien, Cilësitë dhe Veprat e Tij, dhe “ue bihamdih”, duke ia atribuar Atij cilësitë e përsosmërisë dhe lavdërimit, për çdoherë që e thotë këtë dhikër, Allahu i mbjell atij një palmë hurme në tokën e Xhenetit.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/4201